



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Astrit DEMA
Pronar/Drejtor
"Top Radio Company" Sh.p.k.
Top Radio
R086
Adresa: S. Pozhegu p.n.
Gjakovë

Ref:1407/923/KPM/II

VENDIM

lidhur me refuzimin e kërkesës për ndryshimin e lokacionit të sistemit të transmetimit të Top Radios - Gjakovë

Fakte

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Top Radio është Ofrues i Shërbimeve Mediale Audio me mbulim lokal, e cila është e licencuar për të transmetuar radio programe në komunën e Gjakovës. Më 30 dhjetor 2009, Top Radio është pajisur me licencë afatgjatë të KPM-së.
3. Me 16 korrik 2014, Top Radio ka parashtruar kërkesën për ndryshimin e vendndodhjes së lokacionit të sistemit transmetues, nga pika e transmetimit Sukë e Cermjanit, për ku janë të licencuar për të transmetuar, për të kaluar me transmetim në majen e Zatriqit.
4. Arsyetimi i pronarit të Top Radios për ndërrimin e lokacionit të sistemit të transmetimit është çështje kontestimore pronësore që ka të bëjë me pronarin e lokacionit në Sukë të Cermjanit, për ku Top Radio është licencuar për transmetim të sinjalit.

5. Më 18 korrik 2014, Departamenti i Menaxhimit Frekuencor (DMF) i KPM-së ka realizuar matjet teknike për të vlerësuar gjendjen faktike në terren si dhe mundësinë për të realizuar ndryshimin e lokacionit të sistemit të transmetimit, sipas kërkesës së Top Radio.
6. Në bazë të vlerësimit të të gjeturave të DMF-së, ndryshimi i lokacionit të transmetimit sipas kërkesës së Top Radio, për të kaluar nga pika e Sukës së Cermjanit në pikën e transmetimit në majën e Zatriqit, rezulton me ndryshime të theksuara të brezit frekuencor radiodifuziv të Republikës së Kosovës.

Arsyetim

7. Ligji Nr. 04/L-44 për Komisionin i Pavarur për Media, përcakton se KPM, është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit si dhe rregullon të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësit e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbime mediale audio-vizuale.
8. Neni 16 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së, paragrafi 1 thekson se: *Përveç dispozitave për bartjen e pronësisë të specifikuar në Nenin 15, i Licencuari paraprakisht parashtron kërkesë me shkrim për ndryshimet e specifikuara në paragrafet e Pjesës 2 të Licencës së KPM-së si dhe në Pjesët 3 dhe 4, përfshirë frekuencën, Fuqinë e Rrezatuar Efektive dhe vendndodhjen e transmetuesit ose antenës, formatin e programit dhe zonën e mbulimit..Ndryshime të tilla mund të bëhen vetëm pasi të jenë miratuar nga ana e KPM-së.*
9. Neni 16 i Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së, paragrafi 2, gjithashtu thekson se: *“Me anë të dërgimit të një njoftimi me shkrim të të Licencuarit, KPM-ja mund të ndryshojë kushtet e Pjesës 2, Standardet Teknike, Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës së transmetimit me një procedurë të përcaktuar në pajtueshmëri me Ligjin e KPM-së. KPM-ja do të sigurohet që këto ndryshime janë të domosdoshme për të garantuar një përdorim më të rregullt të spektrit frekuencor”.*
10. Kërkesa e Top Radios dhe propozimi i pikës për ndryshim të vendndodhjes së sistemit të transmetimit nuk është në harmoni Planin Frekuencor të Republikës së Kosovës, për transmetime radio në brezin frekuencor FM/VHF (87.5 – 108.0 MHz).
11. Frekuenca 103.3 MHz, të cilën e shfrytëzon Top Radio, nuk është e planifikuar dhe e koordinuar për majën e Zatriqit dhe është potencialisht e interferueshme, duke marrë parasysh lartësinë mbidetare prej 1036 m, si dhe do të paraqesë ndryshime të theksueshme në Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës së Top Radio, duke marrë parasysh se Top Radio është e licencuar të transmetojë nga Suka e Cermjanit e cila është pikë me një lartësi mbidetare prej 699 m.
12. Shfrytëzimi i pikave nacionale për transmetime radiodifuzive për mbulim lokal apo regional, gjithashtu është në kundërshtim me Politikën e Transmetimit të KPM-së, e për më shumë, një veprim i tillë do të ndikojë negativisht në zhvillimet përgatitore për fazën e digjitalizimit në Republikën e Kosovës.

13. Komisioni propozon që, Top Radio të përcaktojë një lokacion tjetër që do të jetë i përshtatshëm dhe në pajtim me planin frekuencor të Republikës së Kosovës.

Vendim

14. Komisioni merr vendim që, kërkesa e Top Radio të refuzohet për arsyet e cekura në paragrafin 11, 12 dhe 13 të këtij Vendimi.

Lëshimi i Vendimit

15. Këtë vendim e lëshon Komisioni dhe i njëjti është i vlefshëm që nga data e nënshkrimit të tij.



Adnan MEROVCI
Kryetar
Komisioni i Pavarur i Mediave



16.09.2014
datë